

KONTRATË PËR SHIT-BLERJE KUOTASH

Kjo Kontratë për Shit-Blerje Kuotash (më poshtë referuar si "**Kontrata**"), është nënshkruar sot më 03.06.2016, midis Palëve të mëposhtme:

Znj. Blerina Teka, shtetase shqiptare, lindur në Shijak, Durrës, më 01.01.1972, Shqipëri, dhe mbajtëse e letërnjoftimit nr. 024727914 ("**Shitësi**");

Dhe

Znj. Eneida KOSTA, shtetase shqiptar, lindur në Tiranë, më 29.11.1982, Shqipëri, dhe mbajtëse e letërnjoftimit nr. 032959596 ("**Blerësi 1**");

dhe

Znj. Armida KOSTA, shtetase shqiptar, lindur në Dibër, më 17.02.1976 dhe mbajtëse e letërnjoftimit nr. 031557971 ("**Blerësi 2**");

MEQËNËSE:

- (A) Shitësi zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë "**PLANET**" Sh.p.k. ("**Shoqëria**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("**QKB**"), me Numër Unik Identifikimi ("**NUIS**") K51810504P, me seli në adresën: Rruga M. Ulqinaku, L. nr. 5, Durrës, Shqipëri, me kapital 100.000 (një qind mijë) Lekë;
- (B) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 1 50% të kapitalit të Shoqërisë ("**Kuota e Blerësit 1**") me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek, kundrejt çmimit të barabartë me 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.
- (C) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 2 50% të kapitalit të Shoqërisë ("**Kuota e Blerësit 2**") me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek, kundrejt çmimit të barabartë me 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

SA MË SIPER, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Shitësi pranon t'i shesë Blerësit 1 dhe Blerësi 1 pranon të blejë nga Shitësi Kuotën e Blerësit 1 e cila përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.
- 1.2 Shitësi pranon t'i shesë Blerësit 2 dhe Blerësi 2 pranon të blejë nga Shitësi Kuotën e Blerësit 2 e cila përfaqëson 50% të kapitalit që Shitësi zotëron në Shoqëri, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

Neni 2

Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi që Blerësi 1 dhe Blerësi 2 i paguajnë Shitësit për Kuotën e Blerësit është përkatësisht 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë secili ("Çmimi").
- 2.2 Çmimi do të paguhet me nënshkrimin e Kontratës.

Neni 3

Transferimi i kuotave

- 3.1 E drejta e pronësisë së Shitësit mbi Kuotën e Blerësit 1 dhe Kuotën e Blerësit 2 do të transferohet në favor të Blerësit 1 dhe Blerësit 2 me nënshkrimin e Kontratës.
- 3.2 Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit 1 dhe Blerësit 2 të gjithë dokumentet, deklaratat ose certifikatat e nevojshme për përmbushjen e transferimit të Kuotës të Blerësit 1 dhe Kuotës të Blerësit 2 përkatësisht në favor të Blerësit 1 dhe Blerësit 2 dhe për regjistrimin e këtij transferimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se është pronari i ligjshëm i 100% të kapitalit të Shoqërisë sikurse vërtetohet nga ekstrakti i datës i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, bashkëngjitur Kontratës, dhe se nuk ka ndonjë pretendim nga ndonjë pale

tretë ndaj të drejtës së pronësisë mbi Kuotat, ekzistues apo të mundshëm, i cili mund të ketë efekt material negative në të drejtën e pronësisë mbi Kuotat.


- 4.2 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se Kuota objekt shitje nuk është objekt i ndonjë kufizimi, barre apo pengu në favor të ndonjë pale të tretë.

Neni 5


Dispozita të Përgjithshme

- 5.1 Kontrata është hartuar dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- 5.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve do të jetë në kompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.3 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse i dorëzohen dorazi, ose me postë të regjistruar Palës në adresën e përcaktuar më sipër.
- 5.4 Kontrata është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në Shqip me të njëjtën vlerë secila.

Shitësi


Blerina Teka

Blerësi 1


Eneda KOSTA

Bleresi 2


Armida KOSTA




VENDIM I ORTAKUT TË VETËM TË
SHOQËRISË "PLANET" Sh.p.k.

Datë 03.06.2016

Sot më datë 03.06.2016, unë Blerina Teka, shtetase shqiptare, lindur në Shijak, Durrës, më 01.01.1972, Shqipëri, dhe mbajtëse e letërnjoftimit nr. 024727914, në cilësinë e ortakut të vetëm dhe zoteruese e një kuote ("Kuota") që përben 100% kapitalit të shoqërisë "PLANET" sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik Identifikimi K51810504P, me seli në adresën: Rruga M. Ulqinaku, Lagjja nr. 5, Durrës, Shqipëri ("Shoqëria"), vendosa, si më poshtë:

1. Miratimin e shitjes së 100% të kapitalit të Shoqërisë përkatësisht tek blerësit:
 - a. **Znj. Eneda Kosta**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 29.11.1982, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 032959596, e cila do të zotërojë një kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë; dhe
 - b. **Znj. Armida Kosta**, shtetase shqiptare, lindur në Diber, më 17.02.1976, dhe mbajtës i letërnjoftimit nr. 031557991, e cila do të zotërojë një kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë


Blerina Teka